



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 848/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të cilit iu kanë bashkangjitur edhe 119 kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës, nga subjektet politike LVV, LDK, PDK, AAK, NISMA, PP, UB, IQ, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet i bazuar apeli: A.nr. 848/2021, i paraqitur nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të cilit iu kanë bashkangjitur edhe 119 kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës, nga subjektet politike LVV, LDK, PDK, AAK, NISMA, PP, UB, IQ, dega në Komunën e Podujevës, kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Podujevë, nga të gjitha subjektet politike në Vendvotimet:

1801E/01R, 1801E/02R, 1801E/04R, 1801E/05D, 1801X/03R, 1801X/04D, 1802E/01R, 1802E/02R, 1802E/03R, 1802E/05D, 1802X/01R, 1802X/02R, 1802X/03R, 1802X/04D, 1803E/01R, 1803E/02R, 1803E/03D, 1804E/01R, 1804E/03D, 1805E/01D, 1807E/01R, 1807E/02R, 1807E/03D, 1808E/02D, 1809E/01R, 1810E/02D, 1811E/01D, 1812E/01R, 1812E/02R, 1812E/03R, 1812E/04D, 1813E/01R, 1813E/02D, 1814E/01R, 1814E/02R, 1814E/03D, 1815E/01R, 1816E/01R, 1816E/02R, 1817E/01R, 1817E/02D, 1818E/01R, 1818E/02D, 1819E/03D, 1820E/01R, 1820E/02R, 1820E/03D, 1821E/01D, 1823E/01R, 1823E/02D, 1824E/01R, 1824E/02R, 1824E/03R, 1824E/04R, 1824E/05R, 1824E/07R, 1824E/09R, 1824E/10R, 1824E/11R, 1824E/13R, 1824E/14R, 1824E/15D, 1825E/01D, 1827E/01R, 1827E/02R, 1827E/03D, 1828E/01D, 1829E/01R, 1829E/02D, 1830E/01R, 1830E/02D, 1831E/01R, 1831E/02D, 1832E/01R, 1833E/01R, 1834E/01R, 1835E/01D, 1836E/01D, 1837E/01R, 1837E/02D, 1838E/01D, 1839E/02D, 1841E/01R, 1841E/02D, 1842E/01D, 1843E/01R, 1843E/02D, 1844E/01D, BM118/001, BM218/001, CB118/001, CB118/002, CB118/003, CB118/004, CB218/001, CB218/002, CB218/003, CB218/004.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet, te cituara si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datën 04.11.2021 ka pranuar apelin Anr. 848/2021, të paraqitur nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të cilit iu kanë bashkangjitur edhe 119 kandidatë

për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës, nga subjektet politike LVV, LDK, PDK, AAK, NISMA, PP, UB, IQ, dega në Komunën e Podujevës, pra 55,35% të cilët kërkojnë rinumërim të plotë të gjitha vendvotimeve në Komunën e Podujevës, duke i përjashtuar nga kërkesa për rinumërim vendvotimet e rinumëruara nga KQZ-ja, para se të shpallet rezultati përfundimtar. Parashtruesit e apelit theksojnë se kanë shumë fakte për manipulime të votave, ku një ndër faktet kryesore ishte që nga rinumërimi i vetëm 19 vendvotimeve, ka ndryshime të mëdha me vota të kandidatëve, ku si shembull LDK pas rinumërimit, dy kandidat humbin ulësen dhe zëvendësohen me dy të tjerë, prandaj propozojnë që të bëhet rinumërimi total i këtyre vendvotimeve. Të njëjtit kërkojnë që të bëhet rinumërimi i plotë i kutive të votimit për kandidatet për Kuvend Komunal të Podujevës, për arsye se janë vërejtur shumë parregullsi gjatë numërimit të votave në vendvotime dhe KKZ në Podujevë, dhe ka një shpërputhje të madhe të raportimeve nga ana e vëzhguesve të Partive politike dhe FRP-ve zyrtare të dala nga KKZ. Parashtruesit e apelit theksojnë se fakti më i rëndësishëm që vota është keqpërdorur është edhe bashkimi i të gjithë kandidatëve nga të gjitha subjektet politike për të kërkuar rinumërim të plotë, dhe për këtë theksojnë se kanë shumë fakte e prova të cilat i kanë bashkangjitur kësaj ankese.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

- apeli është i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me provat e ofruara nga pala ankuese. Vet fakti se të gjitha subjektet politike LVV, LDK, PDK, AAK, NISMA, PP, UB, IQ, të certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, kontestojnë numërimin e fletëvotimeve në Komunën e Podujevës, për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja, vërtetë bëhet i kontestueshëm nga të gjithë garuesit në këto zgjedhje, i cili rezultat me bazë dhe argumente e prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, edhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP gjen se, përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat asambleist del rezultat zgjedhor më i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Podujevë nga të gjitha subjektet politike për vendvotimet e cekura si në pjesën II të dispozitivit, dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i

fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, andaj PZAP, nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 848/2021 më datën 05.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.